

PLANI STRATEGJIK

2014 - 2017

Tiranë, janar 2014

Administrata tatimore fokusohet mbi menaxhimin e rriskut me synim që të caktojë në mënyrën më të mirë burimet e njerëzore dhe logjistike që ka në dispozicion, për të arritur një nivel optimum të përmbushjes afatgjatë të kërkesave të legjislacionit tatimor nga tatimpaguesit, për të mos lënë pa mbledhur të gjithë ato të ardhura tatimore që kanë mundësi të mbliidhen.

Mesazhi

i

Drejtorit të Përgjithshëm

Të nderuar tatimpagues,

Administrata tatimore ka përgatitur planin strategjik afatmesëm për periudhën 2014-2017, mbështetur në Programin e Qeverisë, shtjelluar në këtë dokument me qëllim që të orientohet drejtë dhe saktë në punën e saj për katër vitet e ardhshme.

Për këtë qëllim administrata tatimore do të luftojë vazhdimisht arbitraritetin në përdorimin e masave shtrënguese për kapërcyer vështirësitë serioze dhe çdo të papritur të pakëndshme në marrëdhëniet e saj me komunitetin e tatimpaguesve duke pasur si alternativë:

- menaxhimin strategjik, ose procesin e menaxhimit të përpjekjeve për të arritur misionin e saj organizativ, ndërkohë që menaxhon marrëdhënien me mjedisin ku ushtron veprimtarinë;
- një tërësi vendimesh dhe veprimesh që rezultojnë në formulimin dhe vënien në jetë të strategjive të hartuara për të arritur objektivat e vendosur;
- procesin e shqyrtimit të mjedisit të kohës korente dhe të së ardhmes, duke formuluar objektivat, marrjen, vënien në jetë dhe kontrollin e vendimeve që fokusohen mbi arritjen e objektivave të vendosur;
- një proces të vazhdueshëm që përfshin përpjekjet për të përshtatur ose përputhur administratën tatimore në mënyrën më përparësore të mundur me mjedisin që ndryshon.

Qëllimi i planit strategjik dhe planit operacional është:

- dokumentimi dhe komunikimi i vizionit, misionit dhe vlerave;
- puna e përbashkët, qëllimet, objektivat dhe planet e veprimit në përputhje me misionin;
- lejimi i administratës tatimore të vendosë përparësitë në burimet e kufizuara financiare dhe njerëzore që ka në dispozicion; dhe
- lejimi i sistemeve të IT të punojnë sëbashku me qëllim që raportimi të sigurojë një informacion plot domethënie për të vlerësuar dhe matur performancën.

Me prioritetet që përmban, Plani Strategjik dëshmon rëndësinë e tyre dhe faktin që DPT – ja do të arrijë ta përmbushë misionin e saj për t'i çuar përpara qëllimet kryesore, duke shpjeguar se si do t'ia arrijë këtyre qëllimeve, duke bërë të mundur që tatimpaguesit që kryejnë evazion fiskal të përballen me një mjedis më të vështirë, si dhe me rritjen e mundësisë për t'u zbuluar dhe ndëshkuar nga administrata tatimore.

Shumica e tatimpaguesve, që veprojnë normalisht në përmbushjen e kërkesave të legjislacionit tatimor do të përfitojnë edhe më shumë nga përmirësimi i vazhdueshëm i shërbimeve që do t'u sigurojë administrata tatimore, e cila do të jetë e angazhuar të punojë më shumë për edukimin e tatimpaguesve, nëpërmjet formave dhe metodave që ndihmojnë në përmbushjen e detyrimeve tatimore. Një nga mënyrat më të mira të edukimit të tatimpaguesve do të jetë aftësia e DPT për të përmbushur misionin e saj me drejtësi dhe efektivitet në favor të të gjithë tatimpaguesve dhe qytetarëve shqiptarë.

Bindja ime është se ndryshimi që të gjithë duam kalon nga dialogu mes nesh dhe biznesit, përgjegjësia e secilit në raport me ligjin, partneritet në shërbim të biznesit dhe të vendit. Administrata tatimore do të bashkëpunojë me komunitetin e biznesit, shoqatat e tij përfaqësuese (dhomat e tregtisë dhe industrisë dhe të tjera të ngjashme), si dhe me ndërmjetësit e njohur me ligj si ekspertët kontabël të autorizuar, kontabilistët e miratuar, etj, me qëllim që zëri i tatimpaguesve të dëgjohet në funksion të zbatimit të sistemit tatimor.

Administrata tatimore do të punojë për të rritur edhe më tej cilësinë e shërbimeve, nëpërmjet konsolidimit të qendrave të reja bashkëkohore me një përvojë pozitive të shërbimeve duke i shtrirë këto shërbime cilësore edhe në qendra të tjera të konsiderueshme urbane, sikundër është deklarimi elektronik i tatimeve, si dhe do të përmirësojë kapacitetin për të evidentuar dhe ndëshkuar tatimpaguesit që kryejnë evazion fiskal dhe konkurrojnë padrejtësisht në treg.

Përmirësimet e planifikuara në administratën e tatimeve, janë thelbësore për ruajtjen e stabilitetit fiskal afatgjatë, rritjen e veprimtarisë ekonomike të vendit dhe ofrimin e mjedisit të përshtatshëm për investimet e huaja. Krahas kësaj, përmirësimi i administratës së tatimeve, është themelor për integrimin e Shqipërisë në Evropë.

Brisida Shehaj

Drejtore i Përgjithshëm

Vizioni i Administratës Tatimore

Administrata tatimore do jetë partnere me komunitetin e biznesit dhe me qytetarët shqiptarë në procesin e ndërtimit të vendit, nëpërmjet administrimit efektiv dhe eficient të një politike tatimore të drejtë dhe të paanshme, me qëllim që tatimpaguesit t'i përmbushin me vullnet të lirë kërkesat dhe detyrimet që përmban legjislacionit tatimor

Misioni i Administratës Tatimore

Misioni i administratës tatimore është:

- administrimi me efektivitet dhe efikasitet i legjislacionit tatimor;
- bërja e lehtë për tatimpaguesit e përmbushjes së kërkesave të legjislacionit tatimor;
- përdorimi me drejtësi të masave shtrënguese për përmbushjen e kërkesave të legjislacionit tatimor;
- sigurimi i shërbimeve cilësore për tatimpaguesit;
- ngritja e vazhdueshme e aftësive profesionale të zyrtarëve tatimorë dhe ndërtimi i një administrata tatimore profesionale dhe të motivuar;

Vlerat e Administratës Tatimore

Vlerat e administratës tatimore janë:

integriteti, për t' i kryer detyrat me vërtetësi, ndershmëri dhe në mënyrë transparente;

përgjegjshmëria, për të qenë e përgjegjshme për veprimet dhe rezultatet e saj;

përgjigja, për të qenë e ndjeshme, e shpejtë, e drejtë dhe objektive në marrëdhëniet me tatimpaguesit dhe të interesuar të tjerë, duke forcuar besimin e ndërsjellë;

profesionalizmi, për t'u përpjekur fort për të përmirësuar performancën dhe kompetencën me fokus arritjen e më të mirës;

krijimtaria, për të inkurajuar ide, metoda, procese dhe praktika të reja;

bashkëpunimi, për të punuar sëbashku me tatimpaguesit dhe të interesuarit e tjerë për të arritur qëllimet e përbashkëta.

Objektivat e Administratës Tatimore

Objektivat e administratës tatimore janë:

- Mbledhja e të ardhurave të parashikuara në Programin e Qeverisë nëpërmjet:
 1. zbatimit efektiv dhe eficient të legjislacionit tatimor;
 2. Implementimi i një programi të Ri TI “E-Taxation”
 3. publikimit të legjislacionit tatimor, rregullave dhe procedurave në zbatim të tij;
 4. vetëvlerësimit dhe vetëdeklarimit të detyrimeve tatimorë, ndjekjes së ndryshimeve në mjediset e biznesit, përshtatjes së sistemeve të organizimit të burimeve, të teknologjisë së informacionit dhe proceseve të punës për të arritur efektivitetin dhe eficientë;
 5. rritjes së vazhdueshme të aftësive profesionale në mbledhjen e të ardhurave dhe zvogëlimin të evazionit tatimor
- Evidentimi dhe zvogëlimi i rrisqeve të mospërbushjes së objektivave të administratës tatimore;
- Sigurimi i shërbimeve cilësore për tatimpaguesit;
- Përdorimi me drejtësi i masave shtrënguese për përmbushjen e kërkesave të legjislacionit tatimor.

Kuadri ligjor

Gjatë zbatimit të kërkesave të legjislacionit tatimor, udhëzimeve dhe procedurave, administrata tatimore vepron me drejtësi dhe garanton respektimin e të drejtave të tatimpaguesve dhe të parimit të barazisë përpara ligjit. Administrata tatimore bën çdo përpjekje për të siguruar barazi në zbatimin e politikave fiskale të qeverisë. Administrata tatimore vepron në përputhje me kuadrin ligjor dhe me parimet e etikës administrative, me qëllim respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të individëve dhe bizneseve.

Legjislacioni tatimor, objekti i të cilit janë tatimet e drejtpërdrejta dhe të tërthorta, kontributet e sigurimeve shoqërore dhe taksat kombëtare përbëjnë bazën mbi të cilën ngrihet kuadri i detyrueshëm ligjor për administrimin e sistemit tatimor.

Qëllimet strategjike të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për vitin 2014 - 2017

1. Lehtësimi i përmbushjes së legjislacionit tatimor me anë të një shërbimi të përmirësuar dhe modern për tatimpaguesit

Treguesit e performancës

- Shërbim cilësor modern elektronik për tatimpaguesit
- Përmbushje e kërkesave të legjislacionit tatimor me kosto më të ulta për tatimpaguesit
- Eficiencë e rritur e zyrtarëve të administratës tatimore, si rezultat i përdorimit të teknologjisë së re modern - “E-Taxation” të informacionit, që zyrtarët të merren me analizën dhe kontrollin e deklaratave tatimore
- Zvogëlimi në mënyrë domethënëse i rrisqeve të mospërmbushjes së kërkesave të legjislacionit tatimor

2. Përmirësimi i mbledhjes së taksave bazuar në strategjinë e Modelin e RI të riskut të pajtueshmërisë me tatimet dhe taksat.

- Frenimi evazionit dhe mashtrimit tatimor
- Përdorimi i gjitha masave të mundshme për pajtueshmërinë me taksat
- Shërbime të mundshme për tatimpaguesit, që konsiderohen të pershtatshme për këtë qëllim.
- Përdorimi i një **Modeli të Ri Risku** për të evidentuar grupet e taksapaguesve që kanë sjellje të ngjajshme. Vëmendja tek grupi që kanë shkelje të mëdha.
- Zhvillimi i Modelit të Ri të Riskut në DPT mbështetur në:
 - Zhvillimin e modelit të bazuar në Program TI “E-Taxation”
 - Edukimi i grupeve të veçanta të tatimpaguesve dhe segmenteve të industrisë do të zhvillohet për të rritur pajtueshmërinë.

3. Zgjidhja efektive e problemit të mospërmbushjes

- Forcimi i kapaciteteve administrative
- Forcimi i kapaciteteve administrative dhe procedurave në fushën e TVSH – së (veçanërisht, lëshimi dhe kontrolli i faturës tatimore me TVSH)
- Përmirësimi i procedurave tatimore në drejtoritë rajonale tatimore
- Përmirësimi i procedurave të kontrollit tatimor nëpërmjet analizës së riskut

Të ardhurat kryesore tatimore në buxhetin e shtetit gjenerohen nga TVSH – ja, ndërkohë që sasia më e madhe e të ardhurave tatimore në të gjithë llojet e tatimeve gjenrohet nga tatimpaguesit e mëdhenj, **prandaj përmirësimi dhe forcimi i kapaciteteve administrative dhe procedurave që lidhen direkt me tatimpaguesit e mëdhenj dhe TVSH është një qëllim strategjik vendimtar.**

- ***Forcimi i kapaciteteve administrative***

Procedurat administrative që lidhen direkt me tatimpaguesit duhen përmirësuar, duke i dhënë rrugëzgjdhje individuale çdo tatimpaguesi, duke angazhuar zyrtarët tatimorë më të ditur. Qëllimi i DPT do të jetë përmirësimi i shërbimeve për një numër relativisht të vogël tatimpaguesish që gjenerojnë mbledhjen e sasisë më të madhe të të ardhurave tatimore midis strukturave organizative të administratës tatimore. Në një periudhë afatmesme do të paraqitet një ndryshim organizativ, i cili do të bëjë të mundur një procedurë tatimore të cilësisë më të mirë për tatimpaguesit e mëdhenj.

- ***Forcimi i kapaciteteve administrative dhe procedurave në fushën e TVSH – së***

Meqenëse TVSH gjeneron pjesën më të madhe të të ardhurave tatimore në buxhetin e shtetit përmirësimet në fushën e procedurave që lidhen direkt me TVSH do të jetë qëllim tjetër strategjik i administratës tatimore, duke marrë në konsideratë edhe faktin që TVSH është një tatim kyç në pranimin e vendit në BE.

- ***Përmirësimi i procedurave tatimore në Drejtoritë Rajonale***

Mbledhja në kohë e tatimeve dhe kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore është detyra kryesore e administratës tatimore dhe, me qëllim që të arrihet mbledhja më e madhe e mundshme dhe për këtë është thelbësore që procedurat tatimore në drejtoritë rajonale të përmirësohen. Me prezantimin e e-shërbimeve për tatimpaguesit, do të përmirësohet në mënyrë domethënëse funksioni i kontrollit tatimor, për shkak të zvogëlimit të operimeve të shumtë ditorë që lidhen direkt me hyrjen e të dhënave nga formularët dhe kohës shtesë që do të përdoret për të përmirësuar funksionin e kontrollit.

Zyrtarëve tatimorë dhe menaxhimit të DRT-ve do t'u sigurohen kurse të veçanta trajnimi me qëllim që të marrin njohuri dhe aftësi profesionale të veçanta mbi zbatimin e teknikave moderne që kërkon kontrolli tatimor dhe kontrolli në tavolinë, ku do të përfshihet analiza e rriskut.

4. Përmirësimi i procedurave të kontrollit tatimor

- Modeli i Ri Risku për përzgjedhjen e tatimpaguesve për kontroll.
- Sistem modern TI implementimi “E- Taxation”.

Tatimpaguesit do të përzgjidhen për kontroll mbi bazën e sinjaleve të marrë, dhe perpunuara nepermjet **Modelit të RI të Riskut dhe Sistemit “E-taxation”**. Proçedurat e përmendura do të sigurojnë zbatimin e parimit të drejtësisë në proçedurën e të tatuarit.

Përmbushja e detyrimeve tatimore dhe dorëzimi në kohë i deklaratave të sakta tatimore është baza e sistemit të vetëdeklarimit dhe për këtë qëllim administrata tatimore do të planifikojë riprojektimin e proçeseve të biznesit të saj për t’u fokusuar mbi përmirësimin e përqindjes së përmbushjes së legjislacionit tatimor nëpërmjet zbatimit të masave që synojnë identifikimin e fushave të rriskut dhe parimet e menaxhimit të rriskut, me qëllim që kapacitetet ekzistuese të kontrollit tatimor të përdoren në mënyrën më të arsyeshme të mundshme për të kontrolluar tatimpaguesit më me risk.

Administrata tatimore do të vazhdojë me projekte të kontrollit tatimor që synojnë te:

- harmonizimi i proçedurave në nivel të administratës tatimore;
- përzgjedhja në mënyrë objektive e tatimpaguesve për kontroll;
- rritja e efijencës së kontrollit tatimor me anë të ridrejtimit të burimeve njerëzore për kontrollin e atyre tatimpaguesve që klasifikohen me më shumë risk duke ndjekur rezultatet e analizës së rriskut;
- përmirësimin e elementëve të rriskut që evidentohen gjatë kontrolleve tatimore;
- prezantimi dhe përdorimi i mjeteve të kompjuterit për e–kontroll;
- monitorimi cilësor i rezultateve të kontrollit tatimor nëpërmjet zbatimeve të sistemit të informacionit të administratës tatimore;

5. Përmirësimi i menaxhimit të taksave të arketueshme dhe detyrimeve tatimore të prapambetura (borxhi).

- Thjeshtimi i procedurave
- Përmirësimi i kapaciteteve administrative
- Politika e detyrimeve të prapambetura:
 - Përcaktimi detyrimeve të prapambetura - të pambledhshme - të parashkruara.
 - Rishikimi i rritjes së vlerësimeve kur tatimpaguesit nuk kanë paraqitur deklaratën e të ardhurave, kjo ka çuar në rritjen e borxhit të pambledhshëm

- Rihartimi skemes per parapagimin e tatimit mbi fitimin me qellim dekurajimin e nen-raportimit te fitimit ne deklaraten vjetore.

6. Permiresimi i sistemit TI te administrates tatimore

- Modernizimi sistemit të TI, – risi dhe reforme e rendesishme.
 - Ulje e kohes se pagimit te taksave
 - Ulja e kostove administrative per ATQ dhe Tatimpaguesit
 - Shmangien e kontakteve te tatimpaguesit me Administraten Tatimore
 - Permiresimi te berit biznes ne Shqiperi.

7. Krijimi i nje nderfaqeje fikse midis sistemit tatimor dhe thesarit

- Krijimi i nje faqe direkte midis zyrave te tatimeve dhe sistemit te thesarit ne menyre qe Departamenti i Thesarit te njihet ne baze ditore, dhe jo vetem njehere ne muaj me tatimet e mbledhura.
- Rimbursimi tvsh-se

Kjo do te ndihmoj,permiresimin e parashikimit te fluksit hyres te te ardhurave tatimore

8. Përgatitja për anëtarësimin në BE, duke përmbushur angazhimet që rrjedhin nga përmbushja e kërkesave të Bashkimit European dhe inkorporimi DPT-së në grupin e punës për hartimin e Programit Ekonomik Fiskal 2014, për të garantuar që informacioni i dhënë të jetë i përshtatshëm dhe i krahasueshëm me programet e vendeve të tjera candidate potenciale.

- Përfaqesimi i DPT-se në grupin e punë që është ngritur në Ministrine e Financave;
- Sigurimi i informacioneve sasiore, sipas standarteve të tabelave në Aneksë të përgatitura për plotësime;